



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 90 , Datë 08 / 09 / 2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.41 Regj., datë 18.04.2016, e N. M, kundër Bashkisë së Mallakastrës, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

N. M ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë e Ballshit, sot Bashkia e Mallakastrës, në pozicione të ndryshme, nga viti 1993, deri në datën 10.11.2015, kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Me Vendimin nr.1366/1 prot., datë 10.11.2015 “Për lirim nga shërbimi civil” është larguar nga shërbimi civil me motivacionin se: “*...ka refuzuar vendimin për transferimin e tij në pozicionin e nëpunësit civil në Njësinë Administrative Kutë. Ky refuzim është vlerësuar pa shkaqe të parashikuara në pikën 21, të VKM-së nr.171, datë 26.03.2014*”.

Subjekti ankues pretendon se lirimi i tij nga shërbimi civil është bërë në kundërshtim të hapur me dispozitat e ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Në këto kushte, z.M pretendon se, vendimi për lirimin e tij nga detyra është vendim politik, për arsyen se është paragjykuar dhe konsideruar i padëshirueshëm nga drejtuesi aktual i Bashkisë së Mallakastrës, për shkak të funksioneve që ka pasur në administratën e këtij institucioni para se në krye të saj të emërohej z.K. Ankuesi informon se Kryetari aktual i kësaj Bashkie i përket forcës



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

së djathtë politike, ndërsa ai vetë është i angazhuar në subjektin politik të Partisë Socialiste, dhe që të dy janë ekspozuar politikisht, sa i takon bindjeve të tyre politike.

Subjekti ankues pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike dhe kërkon nga Komisioneri, detyrimin e Bashkisë së Mallakastrës të bëjë rikthimin e tij në punë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, **bindjet politike**, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Për sa më lart, si dhe referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përfshihet në fushën e veprimtarisë së Komisionerit dhe ankuesi legjitimohet në paraqitjen e saj.

1. Me shkresën Nr.443/1 prot, datë 19.04.2016 të Komisionerit është njoftuar Bashkia e Mallakastrës, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe iu kërkua informacion mbi pretendimin e ngritur nga z.M.

Me shkresën me nr.657/1 Regj., datë 09.05.2016, Bashkia Mallakastër ka informuar Komisionerin lidhur me pretendimin e ankuesit dhe ka parashtruar argumentet e veta se lirimi nga detyra i z.M është bërë në përputhje me ligjin material dhe procedural dhe vetëm për arsye ligjore dhe aspak për shkak të bindjeve të tij politike. Motivacioni i lirimit të tij nga shërbimi civil ka qenë vetëm për faktin se ai ka refuzuar transferimin e tij në pozicionin si nëpunës civil në Njësinë Administrative Kutë, Bashkia Mallakastër.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 16.06.2016¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë Bashkisë së Mallakastrës.

Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me Kryetarin e Bashkisë së Mallakastrës, i cili informoi se shkak i vetëm për largimin nga shërbimi civil të z.Nebi Memushaj është bërë refuzimi që ai i ka bërë transferimit në Njësinë Administrative Kutë, pasi ankuesi ka pretenduar

¹ Në zbatim të Urdhërit nr.102, datë 13.06.2016, të Komisionerit.

se distanca në kilometra nga vendbanimi i tij² (Ballsh) për në Kutë (Qendra e punës) është më shumë se 30 km. Z.K shprehet se distanca është më pak nga sa pretendon ankuesi, vërtetuar nga matja e bërë nga grupi i punës, i ngritur me urdhër të Kryetarit për verifikimin e kësaj distance. Ky pretendim është shqyrtuar edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe është rrëzuar. Po ashtu, z.Kapllanaj thekson faktin se grupi i auditimit të KLSH-së³ ka gjetur në shkelje dhe ka rekomanduar largimin e menjëhershëm të N. M. Gjatë inspektimit u mor dokumentacioni provues: Kopje e vendimit të Gjykatës Administrative të shkallës së parë Vlorë dhe shkresë me nr.1195/10 prot., datë 13.05.2016, Raport Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar nga Bashkia e Mallakastrës duke u trajtuar në mënyrë të pafavorshme përsa i takon largimit nga shërbimi civil.

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune prej vitit 1993 deri me datë 10.11.2015, kur është liruar nga shërbimi civil. Z.M është me profesion Agronom i Lartë. Që nga viti 1999, me miratimin e Ligjit nr.8549 “Për Statusin e Nëpunësit Civil” ka gëzuar statusin e nëpunësit civil. Pas emërimit të z.Kapllanaj si Kryetar i ri i Bashkisë së Mallakastrës, dhe konkretisht me vendimin nr.1005/4, datë 23.10.2015, z.M është njohur me propozimin për transferimin e tij në Njësinë Administrative Kutë.

Duke e konsideruar të padrejtë këtë transferim, ankuesi me shkresën me nr.1330/1 prot., datë 30.10.2015 ka kërkuar të rishikohet edhe një herë ky propozim me arsyetimin se largësia e vendbanimit të tij nga qendra e punës është më shumë se 30 km. Me shkresën me nr.1366 prot., datë 04.11.2015, të Njesisë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pranë kësaj Bashkie, ankuesi është njohur me përgjigjen e këtij institucioni, ku i bëhet me dije se distanca e pretenduar është më pak se 30 km dhe kundërshtimi i tij nuk është i mbështetur ligjërisht.

Me shkresën me nr.1366/1 prot., datë 10.11.2015 është liruar nga shërbimi civil duke iu ndërprerë marrëdhëniet financiare me Bashkinë e Mallakastrës. Arsyeja e lirimit është si pasojë e refuzimit të tij lidhur me transferimin në Njësinë Administrative Kutë. Ankuesi pretendimet lidhur me verifikimin e distancës i ka kundërshtuar gjyqësisht në Gjykatën Administrative të

² VKM nr.171, datë 26.03.2014, pika 21-23 ka përcaktuar se: “Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njëسيا përgjegjëse, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, vetëm në rast se:

- Gjendja shëndetësore e tij, e vërtetuar me raport mjekësor e bën të pamundur transferimin.
- Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 30 km nga vendbanimi I këtij nëpunësi.

Refuzimi I transferimit për arsye të tjera përveç atyre të pikës 21, përbën shkak për largimin nga shërbimi civil”.

³ KLSH i referohet si shkurtesë: Kontrollit të Lartë të Shtetit.



Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka rrëzuar pretendimet e ankuesit me arsyetimin se distanca e matur është provuar se është më pak se 30 km.

B. Lidhur me provat dhe argumentimin e sjellë nga Bashkia e Mallakastrës mbi pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të bindjeve politike.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, rezulton që, Bashkisë Mallakastër në zbatim të VKM-së nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial” i kanë kaluar në përbërje të saj dhe njësitë e qeverisjes vendore: Bashkia Ballsh, Komuna Qendër Mallakastër, Komuna Aranitas, Komuna Selitë, Komuna Ngracan, Komuna Kutë, Komuna Hekal, Komuna Fratar, Komuna Greshicë. Sa më sipër, i janë transferuar si të drejtat, detyrimet, ashtu edhe personeli i njërive të qeverisjes vendore. Në këtë kuadër është miratuar struktura tranzitore e datës 15.09.2015. Si pasojë e ristrukturimit të gjithë Institucionit dhe miratimit të kësaj strukture, pozicioni i punës së z.M, si Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve është suprimuar. Miratimi i strukturës së re ka përcaktuar dhe pozicionet e reja të punës si dhe kriteret e veçanta për secilin pozicion dhe statusin e trajtimit të tyre. Për këtë shkak Komisioni i Ristrukturimit me shkresën me nr.1005/4 prot., datë 23.10.2015 ka bërë propozimin lidhur me punonjësin Nebi Memushaj. Duke qenë se kualifikimi i tij profesional përshatatet me kriteret ligjore të pozicionit “Specialist Agronom i Lartë” në Njësinë Administrative Kutë, e cila është një zonë që ka më shumë tokë bujqësore se njësitë e tjera administrative, Komisioni ka propozuar transferimin e këtij punonjësi nga pozicioni “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve” të Bashkisë Ballsh, për shkak të suprimimit të vendit të punës në pozicionin “Specialist Agronom i Lartë” në Njësinë Administrative Kutë, Bashkia Mallakastër.

Bazuar në këtë propozim, duke vlerësuar dhe përputhshmërinë e kriterit të kërkuar me arsimimin e z.M, dhe nevojës që kishte kjo njësi administrative për një specialist të lartë agronom, Bashkia Mallakastër me vendimin nr.120/8 prot., datë 23.10.2015 ka vendosur “Transferimin e përhershëm të nëpunësit civil nga pozicioni i mëparshëm i cili është suprimuar (nuk ekziston më) në pozicionin “Specialist Agronom i Lartë” në Njësinë Administrative Kutë, Bashkia Mallakastër. Ankuesi e ka kundërshtuar këtë transferim⁴ dhe me shkresën me nr.1330/1 prot., datë 30.10.2015 ka kërkuar të rishikohet edhe një herë ky propozim. Me shkresën me nr.1366 prot., datë 04.11.2015 Bashkia e Mallakastrës ka shqyrtuar kërkesën e z.M lidhur me pretendimin e tij dhe i ka kthyer përgjigje shkaqeve të tij të refuzimit.

⁴ Me arsyetimin se largësia e vendbanimit të tij nga qendra e punës është më shumë se 30 km.

VKM nr.171, datë 26.03.2014, pika 21 ka përcaktuar se: “Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, vetëm në rast se:

- Gjendja shëndetësore e tij, e vërtetuar me raport mjekësor e bën të pamundur transferimin.
- Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 30 km nga vendbanimi i këtij nëpunësi.

Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përveç atyre të pikës 21, përbën shkak për largimin nga shërbimi civil”.

Bashkia e Mallakastrës hedh poshtë pretendimin e ankuesit se vendbanimi i tij është më shumë se 30 km nga qendra e punës, pasi siç rezulton nga verifikimi në terren dhe në mënyrë topografike, kjo distancë është më pak se 30 km. Distanca është verifikuar dhe matur nga një komision i ngritur enkas me urdhër të posaçëm të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër. Ky verifikim është kryer nga specialistë të fushës topografike, ku krahas konstatimit në vend duke e përshkuar me mjet këtë distancë, janë përdorur gjithashtu në mënyrë topografike imazhet e hartës ortofo, të marra nga albinfo.al⁵.

Relacioni i hartuar nga ky komision me nr. L/1366 Regj., datë 04.11.2015 “Për verifikimin e distancës Ballsh-Kutë” është paraqitur si provë pranë Gjykatës që ka shqyrtuar çështjen e largimit nga shërbimi civil të z.M. Sipas matjeve në terren si dhe matjeve të gjurmës së rrugës duke përdorur hartën ortofo të albinfo.al me shkallë 1:92000 ka rezultuar se, distanca e rrugës Ballsh-Kutë është 29.8 km, pra më e vogël se 30 km.

Lidhur me këtë fakt, është shprehur dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë⁶, e cila me vendimin nr.236 datë 25.02.2016 ka konstatuar se Bashkia Mallakastër ka liruar z.Memushaj nga shërbimi civil pasi prej komisionit përgjegjës është verifikuar se largësia midis vendit ku është transferuar dhe vendbanimit të ankuesit është më pak se 30 km dhe se refuzimi i transferimit nga ankuesi nuk ka qenë në përputhje me pikën 21 të VKM nr.171, datë 26.03.2014.

Pra, transferimi i punonjësit N. M është bërë në përputhje me parashikimet e pikës 21-23 të VKM nr.171, datë 26.03.2014 dhe refuzimi i transferimit për arsye të tjera përveç atyre të pikës 21 të këtij Vendimi, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. Argumentimi i ankuesit se distanca nga vendbanimi i tij deri në qendrën e punës është më tepër se 30 km, bie poshtë nga verifikimet dhe provat e sjella nga Komisioni i ngritur për të matur dhe verifikuar këtë distancë. Nga ana e Bashkisë argumentohet edhe fakti që arsimimi i z.M (me arsim të lartë) “Agronom i Lartë”, binte në kundërshtim me kriterin dhe kualifikimin e kërkuar edhe për pozicionin e punës

⁵ Kopje të këtyre dy hartave janë në dosjen e Ankuesit, pranë KMD-së.

⁶ Ky vendim është i formës së prerë.

që mbante si “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve” të Bashkisë Ballsh, pasi ai pozicion pune kërkonte arsimim “Inxhinier ndërtimi”, “Jurist” ose “Ekonomist”.

Po ashtu, Bashkia e Mallakastrës argumenton dhe provon se largimi nga shërbimi civil i z.M është vetëm për shkaqe ligjore dhe për asnjë motiv tjetër, dhe për këtë ka paraqitur një kopje të “Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet” të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr.1195/10 prot., datë 13.05.2016, në të cilin, në faqen 22 të tij, kreu II: “Ndërprerje të menjëhershme të marrëdhënieve të punës”, citohet se gjen në shkelje z.M⁷ dhe se atij duhet t’i ndërpriten në mënyrë të menjëhershme marrëdhëniet e punës.

Pra përfundimisht, nga gjithë sa rezultoi më lart, lirimi nga shërbimi civil i ankuesit është bërë për shkaqe të mbështetura ligjore dhe të argumentuara në prova e dokumente ligjore. Refuzimi i transferimit ka sjellë për pasojë edhe lirimin e tij nga shërbimi civil. VKM-ja e përcakton qartë se nëse refuzimi bëhet për shkaqe të tjera nga ato të përcaktuara në të, nuk është i justifikuar dhe i mbështetur në ligj. I vetmi argumentim i ankuesit ishte që largësia e përcaktuar në VKM-në e cituar ishte më shumë se 30 km, pretendim i cili u rrëzua nga ana e Bashkisë Mallakastër pasi ajo arriti të provojë të kundërtën.

LMD-ja është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12, pika 1, germa b) parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Për sa më sipër, nuk rezulton të kemi shkelje të nenit 3, pika 2 të LMD-së⁸, i cili përcakton se: “*“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji*”.

C. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesi (bindjet e tij politike), si shkak të sjelljes diskriminuese ndaj tij.

⁷ Z.Memushaj me detyrën e ish përgjegjës të Zyrës së Tatim taksave për periudhën 02.05.2013 deri në 01.04.2014 dhe ish specialist i Zyrës së Tatim taksave për periudhën 01.04.2014 deri në 07.08.2015, në përbërjen e Komisionin e Vlerësimit të Ofertave në përbërjen e KBV, është përgjegjës për mos ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 183,126,533 lekë.

⁸ Në vijim do t’i referohemi si shkurtesë për “Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Për të vërtetuar se ndaj ankuesit ka një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Mallakastër, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁹ dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike. Lidhur me këtë:

- Z.M për të vërtetuar bindjet e tij politike ka sjellë Kartën e Anëtarësisë në PS, me nr.062111.
- Vendimin nr.8, datë 31.05.2005 “Për regjistrimin e kandidatit për deputet”, me të cilin z.M është regjistruar si kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.70.
- Neni 1, i LMD-së i parashikon bindjet politike, si shkak të mbrojtur prej tij.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se ankuesi është anëtar i një partie politike, nuk rezulton i provuar fakti që ai të jetë diskriminuar nga Bashkia e Mallakastrës për shkak të pikëpamjeve politike, dhe se vendimmarrja për largimin e tij nga shërbimi civil të jetë paragjykuar, ndikuar, direkt apo indirekt, për shkak të anëtarësisë së tij në një subjekt politik. Refuzimi i transferimit nga ana e ankuesit ka qenë jo për arsye të parashikuara në pikën 21, të VKM nr.171, datë 26.03.2014 dhe kjo përbën shkak për largimin nga shërbimi civil.

Pra, qëndrimi i Bashkisë Mallakastër ka qenë i ligjshëm dhe jodiskriminues, i mbështetur në argumente të arsyeshme dhe objektive.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 12, pika 1, germa c), nenit 32, germa c), si dhe nenit 33, pikat 10, 11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të N. M, nga ana e Bashkisë Mallakastër, për shkak të bindjeve të tij politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

⁹ Në interpretim të nenit 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Punësim
Shkaku: Bindjet politike
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al